

SËMUNDJET KËRPUDHORE

Fletëpërdredhësja e gjetheve
(*Taphrina deformans*)



RREZIK!

RREZIK!



MBROJTJA KUNDËR FLETËPËRDREDHËSES

Trajtime në qetësi dimërore		Trajtime në vegjetacion	
Fazat kur bëhen trajtimet me fungicide			
			
Rrëzimi i gjetheve	Krasitja dimerore	Zgjimi vegetativ	Fillim vegetacioni

MENDIM BAÇAJ ATHINA LLAMBRO

SEMUNDJET TEK KULTURAT BERTHAMORE

1. Sëmundjet bakteriale

1.1.Kanceri bakterial i pjeshkës, vyshkja bakteriale dhe kroma bakteriale e frutave

Mënyra e përhapjes

Bakteri mbijeton në indet përçuese të degëve të infektuara, në sythat dhe në kanseret e degëve.

Masat e luftimit

Përdorimi i materialit të pastër, evitimi i tokave shumë ranore. Eliminimi i degëve të infektuara, të bëhen krasitje të vona, dezinfektimi i veglave të krasitjes,

Momentet kritike

Për fermerët : blloqet e reja të mbillen me material të pastër.

2. Sëmundjet kërpudhore

2.1.Kalbëzimi i frutave(Monilia)

Mënyra e përhapjes

Infeksioni përhapet nëpërmjet konideve.

Bimët strehuese:

Kajsia, qershia, bajamja, pjeshka, kumbulla.

Shenjat e sëmundjes

Në lule : nxihen dhe thahen duke mbetur të varura në degë.

Në degë : formohen njolla të shtypura, që gradualisht kthehen në plagë kanceroze të hapura

Në fruta : frutat e rinj kalben dhe mbuloen me një masë që është frutifikimi konidial ;

Masat e luftimit

Kajsia : është mirë të bëhet trajtimi para lulëzimit. Kryhen deri në tre trajtime në vit.

Qershia : kryhet vetëm një trajtim kimik, në rast se kushtet klimatike janë të favorshme (shira dhe lagështi e lartë ajrore) dhe shfaqen shenjat e jashtme të sëmundjes.

Bajamja : këshillohet të trajtohet para lulëzimit

Pjeshka : trajtimet kimike kryhen vetëm para lulëzimit, në rastet kur sëmundja arrin nivelin e dëmit ekonomik.

Kumbulla : këshillohen të kryhen trajtime kimike para lulëzimit.

Këshilla praktike :

Për fermerët; të bëhen plehërime azotike të balancuara.

Për shërbimin fitosanitar: të bëhen vërtetime në fushë dhe të analizohen degët e bimëve të dyshuara për praninë e sëmundjes.

Kalbëzimi i frutave

(Monilinia laxa, Monilinia fructigena)



2.2.FLETËPËRDREDHËSJA E GJETHEVE

Shkaktari : Taphrina deformans (Berk) Tul

Mënyra e përhapjes.

Paraziti kalon dimrin me organe të shumëzimit të lokalizuara në të çarat e degëve ose në luspat e sythave.

Bimët strehuese. Pjeshka dhe bajamja

Shenjat e sëmundjes

Në gjethë : shenjat e para duken në gjethet e reja të porsaçelura në formë të fryrjeve të shoqëruara me antocianinë (ngjyrë e kuqe).

Gjethet e infektuara bien para kohë

Në fruta : infeksioni në fruta është më i rrallë.

Në lule : vërehet deformim dhe dështim i tyre.

Lastarët : marrin pamje mishtore me forma të çrregullta

Masat e luftimit

Bëhet një trajtim kimik me rënien e gjethëve. Trajtimi tjetër parashikohet pas krasitjes dimerore, trajtimi i trete bëhet në fazën e porsa fryrjes së sythave. Në rastet e infeksioneve të përvitshme dhe kur kushtet klimatike janë të favorshme për sëmundjen, bëhet dhe trajtimi kimik në fazën e fillimit të vegjetacionit..

Lënda aktive: bazë bakri, ziram, dobinë.

Këshilla praktike



Për fermerët : të përdoren plehra të ekuilibruara azotike dhe të bëhen ujtitje me kriter. Në infeksione të rënda bëhet grumbullimi i degëve dhe largimi i tyre duke i djegur përfundimisht.
Për shërbimet fitosanitare : të bëhen vrojtme në fushë dhe analiza mikrobiologjike të materialit bimor të dyshimtë.